

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Annemarie Meister, kryetare-gjyqtare e Eulex-it, Abdullah Ahmeti dhe Driton Muharremi, anëtarë-gjyqtarë vendorë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Andres Parmas, zyrtar ligjor i EULEX-it, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve H.S. nga Prishtina, B.H1. nga Prishtina dhe M.K. nga Mitrovica për shkak të veprës penale Mashtrim parashikuar me nenin 261 par.1 dhe 2. lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), veprës penale Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, parashikuar me nenin 236 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) dhe veprës penale Lidhja e Kontratës së dëmshme parashikuar me nenin 237 par.1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), Z.S. nga Ferizaji, M.N. nga Prishtina, O.I. nga Vushtrria, B.H1. nga Prishtina dhe H.G. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Mashtrim parashikuar me nenin 261 par.1 dhe 2. lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), Z.S., M.N. dhe B.H1. për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, parashikuar me nenin 236 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), O.I., Z.S., M.N., H.G. dhe B.H1. për shkak të veprës penale Lidhja e Kontratës së dëmshme parashikuar me nenin 237 par.1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësve të akuzuarve, të akuzuarit B.H1. dhe palës së dëmtuar, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.86/2007 datë 23.05.2011, në seancën e kolegjit të mbajtur me 06.02.2014 mori këtë:

A K T V E N D I M

1. Duke e aprovuar pjesërisht ankesat e avokateve mbrojtës për të pandehurit H.S., M.K., Z.S., O.I., B.H1. dhe H.G., si dhe ankesat e të pandehurit B.H1., gjithashtu *ex officio* në lidhje me të pandehurit B.H1. dhe M.N., aktgjykimi P.no.86/2007 i datës 23.05.2011 i marrë nga Gjykata Themelore e Prishtinës anulohet dhe lenda duhet të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim para një paneli tjetër.

2. Akuzat kundër të pandehurve:

- H.S. refuzohen në lidhje me 300 000 Euro kredi kompanisë xxx në shkurt 2004.
- B.H1. refuzohen në lidhje me 231 950 dhe 218 050 Euro kredi ndaj kompanisë xxx1 në mars 2004;
- M.K. refuzohen në lidhje me 300 000 Euro kredi kompanisë xxx2 në shkurt 2004, pasi që ka aritur parashkrimi absolut i këtyre veprave penale.

3. Ankesa e palës së dëmtuar xxx3, hudhet si e pa lejuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.86/2007 datë 23.05.2011, i akuzuari **H.S.**, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale: Mashtrim parashikuar me nenin 261 par.1 dhe 2.lidhur me nenin 23 te Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), për çka është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6 (gjashtë) muaj. Ndërsa konform nenit 390 par.3 të KPPK-së, është liruar nga akuza për shkak të veprave penale Keqpërdorimi i autorizimeve ne ekonomi, nga neni 236 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe veprës penale Lidhja e Kontratës se dëmshme nga neni 237 par.1 dhe 2 të KPK-së, i akuzuari **B.HI.** është shpallur fajtor për shkak të veprës penale: Mashtrim parashikuar me nenin 261 par.1 dhe 2.lidhur me nenin 23 te Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), për çka është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 viteve nuk kryen vepër tjetër penale. Ndërsa konform nenit 390 par.3 të KPPK-së, është liruar nga akuza për shkak të veprave penale Keqpërdorimi i autorizimeve ne ekonomi, nga neni 236 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe veprës penale Lidhja e Kontratës se dëmshme nga neni 237 par.1 dhe 2 të KPK-së, i akuzuari **M.K.**, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale: Mashtrim parashikuar me nenin 261 par.1 dhe 2.lidhur me nenin 23 te Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), për çka është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 6 (gjashtë) muaj. Ndërsa konform nenit 390 par.3 të KPPK-së, është liruar nga akuza për shkak të veprave penale Keqpërdorimi i autorizimeve ne ekonomi, nga neni 236 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe veprës penale Lidhja e Kontratës se dëmshme nga neni 237 par.1 dhe 2 të KPK-së, i akuzuari **Z.S.**, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale: Keqpërdorimi i autorizimeve ne ekonomi, nga neni 236 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për çka është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite. Ndërsa konform nenit 390 par.3 të KPPK-së, është liruar nga akuza për shkak të veprës penale Lidhja e Kontratës se dëmshme nga neni 237 par.1 dhe 2 të KPK-së dhe veprës penale: Mashtrim parashikuar me nenin 261 par.1 dhe 2.lidhur me nenin 23 te Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), i akuzuari **M.N.**, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale: Keqpërdorimi i autorizimeve ne ekonomi, nga neni 236 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për çka është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 viteve nuk kryen vepër tjetër penale. Ndërsa konform nenit 390 par.3 të KPPK-së, është liruar nga akuza për shkak të veprës penale Lidhja e Kontratës se dëmshme nga neni 237 par.1 dhe 2 të KPK-së dhe veprës penale: Mashtrim parashikuar me nenin 261 par.1 dhe 2.lidhur me nenin 23 te Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), i akuzuari **O.I.**, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale: Keqpërdorimi i autorizimeve ne ekonomi, nga neni 236 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për çka është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite dhe për veprën penale Lidhja e Kontratës se dëmshme nga neni 237 par.1 dhe 2 të KPK-së. për çka është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, ashtu që konform nenit 71 të KPK-së, i ka shqiptuar dënimin unik, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve. Ndërsa konform

nenit 390 par.3 të KPPK-së, është liruar nga akuza për shkak të veprës penale Mashtrim parashikuar me nenin 261 par.1 dhe 2.lidhur me nenin 23 te Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), i akuzuari B.H1., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale: Keqpërdorimi i autorizimeve ne ekonomi, nga neni 236 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për çka është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite. Ndërsa konform nenit 390 par.3 të KPPK-së, është liruar nga akuza për shkak të veprës penale Lidhja e Kontratës se dëmshme nga neni 237 par.1 dhe 2 të KPK-së dhe veprës penale, Mashtrim parashikuar me nenin 261 par.1 dhe 2.lidhur me nenin 23 te Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) dhe i akuzuari **H.G.**, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale, Keqpërdorimi i autorizimeve ne ekonomi, nga neni 236 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për çka është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj. Ndërsa konform nenit 390 par.3 të KPPK-së, është liruar nga akuza për shkak të veprës penale Lidhja e Kontratës se dëmshme nga neni 237 par.1 dhe 2 të KPK-së dhe veprës penale: Mashtrim parashikuar me nenin 261 par.1 dhe 2.lidhur me nenin 23 te Kodit Penal të Kosovës (KPK-së). Të pandehurve iu kompensohen shpenzimet e procedurës penale konform nenit 102 par.1 të KPPK, me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit në shumë prej 1000€.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë kanë paraqitur:

-Mbrojtësit e të akuzuarit Z.S., avokatët Osman Havolli dhe Ahmet Hasolli, për shkak të shkeljeve esenciale të dipsozitive të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së kodit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, të aprovoj ankesën e mbrojtësve dhe të akuzuarin Z.S., në mungesë të provave ta liroj nga akuza apo çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe ri vendosje.

Mbrojtësit konsiderojnë se aktgjykimi i atakuar përmban shkelje esenciale të dispozitive të procedurës penale, nga neni 403 par.1 nën par.12 të KPPK, dhe këto shkelje kanë të bëjnë me atë se dispozitivi I aktgjykimit është I pa kuptueshëm dhe kundërthënës me brendinë e tij, ose me arsyet e aktgjykimit, aktgjykimi nuk përfshinë arsyetimin, në te nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare. Sipas mbrojtjes në dispozitivin II, të aktgjykimit aktual gjykata duke bërë përshkrimin e punëve dhe detyrave të punës, me përgjegjësinë e tij, në procesin e punës për Z.S.n, rrjedh se ai paska qenë i punësuar në marrëdhënie të rregullt të punës në bank dhe në pozitën kyqe të kryetarit të këshillit menagjues të xxx3, e që për pasojë me fajin e tij, nga BQK, kësaj banke i është revokuar licenca. Sipas mbrojtjes Z.S., shpallet fajtor jo sipas aktakuzës në vazhdimësi, por sipas një vlerësimi të vet gjykatës, e cila në mënyrë autonome e ka hartuar një dispozitiv të aktgjykimit, kundër Z.S.t, në pikën II, i cili juridikisht është në kundërshtim me ligjin. Këshilli Qeverisës i xxx3, dhe kryetari i saj Z.S., është viktimë e mashtrimeve për të cilat mbahet përgjegjës dhe dënohet duke ditur se nuk kishte asnjë përfitim personal për vete apo të organizatave të tij, e nga kjo shifet se dispozitivi i aktgjykimit, është i pa kuptueshëm dhe kundërthënës me vetveten. Sipas mbrojtjes, shtrohet pyetja si është e mundur që Z.S., të përgjigjet

për veprimet e dikujt tjetër, pra, për M.N.n, B.H1., M.K., B.H1. dhe H.G., për të cilët thuhet se secili veç e veç, për qëllime të përfitimeve personale dhe organizatave të tyre të biznesit, e kanë mashtruar xxx3, duke fshehë fakte lidhur me gjendjen e tyre financiare, pra është mashtruar edhe Z.S., nga ana e tyre e i cili është shpallur fajtor për veprat penale të cilat nuk i ka kryer. Nga kjo mund të konkludohet se ka shkelje esenciale të dispozitave të KPPK, nga neni 403 par.1 lidhur me nën par.10 të KPPK.

Gjendja faktike është vërtetuar gabimisht ngase e njëjta nuk është e bazuar në asnjë provë konkrete dhe mbetet një shkrim i hetuesve që nuk është asgjë më shumë se spekulime dhe trillime. Nga të gjitha këto prova në asnjë formë nuk është dëshmuar se Z.S., duke qenë në pozitën e Këshillit Qeverisës të xxx3, ka kryer veprën penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, ngase me asnjë provë të vetme nuk e dëshmon qëllimin e veprës penale, respektivisht përfitimin material, për vete apo organizatën e tij. Në këtë çështje penale, është shkelur edhe Kodi Penal, sipas nenit 404 par.1 nën par.1 të KPPK, sepse vepra për të cilën është akuzuar Z.S., nuk është vepër penale.

-Mbrojtësit e të akuzuarit H.S., av.Qerim Metaj dhe Avdi Ahmeti, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së kodit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, të aprovoj ankesën e mbrojtësve dhe të akuzuarin H.S., në mungesë të provave ta liroj nga akuza apo çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe ri vendosje.

Mbrojtja konsideron se aktgjykimi i kundërshtuar në pikën I të aktakuzës, me të cilën i akuzuari H.S., është shpallur fajtor për veprën penale të mashtrimit nga neni 261 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK, dhe e ka dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4(katër)vite e 6(gjashtë)muaj, si i tillë është i kundërligjshëm ngase i njëjti është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 403 par.1 pika 10 të KPPK, ngase gjykata ka bërë tejkalimin e akuzës, ku të njëjtin e ka shpallur fajtor për veprën penale të mashtrimit nga neni 261 pr.1 dhe 2 të KPK. Këtë sipas mbrojtjes gjykata nuk ka pasur drejtë ta bëjë nga fakti se i njëjti nuk ka qenë i akuzuar për këtë vepër penale as me aktakuzë e as në shqyrtimin gjyqësor, por i njëjti ka qenë i akuzuar dhënie të ndihmës në kryerjen e veprës penale të mashtrimit, nga neni 261 par.1 dhe 2 e lidhur me nenin 25 të KPK. Andaj, sipas mbrojtjes vetëm kjo shkelje esenciale e bënë aktgjykimin të pa qëndrueshëm. Mbrojtja gjithashtu cekë se aktgjykimi ishte shpallur me dt.23.05.2011, kurse i njëjti palëve u është dërguar me dt.12.12.2012, që do të thotë 19 muaj pas shpalljes së tij, për çka është vepruar në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Sipas mbrojtjes dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar në të cilën është përfshirë edhe i akuzuari H.S., është i pa qartë dhe i pa kuptueshëm. Në anën tjetër dispozitivi është kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin e tij, por edhe me përmbajtjen e provave dhe procesverbaleve të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Përshkrimi i dispozitiviti të aktgjykimit, nuk i përmban elementet e veprës penale të mashtrimit, pasi që i akuzuari H.S., me asnjë veprim nuk e kishte vënë në lajthim xxx3, pra ky i akuzuar nuk kishte prezantuar apo paraqitur kurrfarë fakte të rrejshme me rastin e realizimit të kredive të tij(dy kredi). Në rastin konkret kemi të bëjmë me raport civilo juridik. I akuzuari H.S., ka realizuar dy kredi dhe ato plotësisht në pajtim

me kushtet dhe kriteret të cilat i kishte caktuar xxx3, e jo i akuzuari H.S.. Këtë e vërtetojnë edhe dëshmitarët D.P. dhe N.S., të cilat shprehimisht kanë deklaruar se gjithë dokumentacionin me rastin e aplikimit për kredi i akuzuari H.S., e ka pasur tërësisht në rregull, duke iu përmbajtur kushteve dhe kriterëve të cilat i ka caktuar vetë xxx3.

Gjithashtu, eksperti financiar X.K., pas ekzaminimit të dokumentacionit që i përket kredi marrësve, të trajtuar sipas aktakuzës si grupi “H”, është vërtetuar se të gjithë kredimarrësit kanë aplikuar dhe kanë kontraktuar në emër të vet dhe për interes të bizneseve të tyre. Subjektet afariste të cilat i udhëheq i akuzuari H.S., kanë pasur një qarkullim financiar vjetor prej afër 6.000.000,00Euro dhe të njëjtat kanë pasur mbulesë të mjaftueshme për marrjen e çfarëdo kredie, e që kjo është vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit financiar. Shton po ashtu se i akuzuari H. ka pasur një rëndësi të kreditit me afat kthimi prej 36 muaj me greis periudhë prej 6 muajve dhe tjetrën me kredi revaluose në afat kthimi prej 12 muajve të cilën e ka realizuar pjesë pjesë, duke lënë kolateral tre herë më shumë, por që i njëjti nuk ka mundur të dijë se banak do të likuidohet me 13.03.2006 ku ende nuk kishte arritur afati për kthimin e kredive të paraparë me kontratë.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.K., av.Nikë Shala, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së kodit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, të aprovoj ankesën e mbrojtësve dhe të akuzuarin M.K., në mungesë të provave ta liroj nga akuza.

Mbrojtësi pretendon se aktgjykimi është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPK, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, ose me arsye të aktgjykimit, ngase aktgjykimi nuk përfshinë arsyet lidhur me faktet vendimtare. Të gjitha këto shkelje kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penale. Sipas mbrojtjes as gjendja e fakteve në këtë çështje penale nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Dashja et ë akuzuarit për ta kryer veprën penale, nuk është vërtetuar me asnjë provë. I njëjti tri herë ka aplikuar për kredi, në procedurë të rregullt, me dokumentacion valid, ju kanë ndarë kreditë, ashtu që kredinë e parë dhe të dytë, i ka paguar në tërësi. Pastaj ka marrë kredinë e tretë, e cila iu ka lejuar ndërsa ka mbetur një pjesë të borxhit pa e kryer. Marrja e kredive ka qenë individuale, ashtu që dëshmitari B.P., në “T.F.”, si në fazën hetimore ashtu dhe shqyrtimin kryesor ka deklaruar se kredia është e tij dhe se ai është përgjegjës për borxhin e jo i akuzuari M.K.. Mbrojtja konsideron se në rastin konkret me asnjë provë nuk është dëshmuar se kemi të bëjmë me grupin “K”, sepse për të ekzistuar një grup duhet të ekzistojë së pari ndonjë marrëveshje e lidhur në mes palëve, anëtarëve, e nënshkruar dhe vërtetuar në mes tyre, ku dihen të drejtat dhe obligimet në mes tyre. Në rastin konkret, pra, kemi edhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, ngase në rastin konkret në veprimet e të akuzuarit nuk ekzistojnë elementet e veprës penale të mashtrimit, për të cilat është akuzuar.

-Mbrojtësi i të akuzuarit O.I., av.Abdylaziz Sadiku, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së kodit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, të aprovoj

ankesën e mbrojtësve dhe të akuzuarin Z.S., në mungesë të provave ta liroj nga akuza apo çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe ri vendosje. Sipas mbrojtjes aktgjykimi i atakuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase i njëjti nuk është i mbështetur në dispozitat e nenit 387 të KPPK. Nga dispozitivi i pikës II, pika a, të aktgjykimit të atakuar rezulton se të pandehurit Z.S., M.N., O.I., B.H1. dhe H.G., janë shpallur fajtor për shkak se kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, sipas nenit 236 par.1 pika 5 dhe par.2 lidhur me nenin 23 të KPK. Kur të lexoni këtë do të hasni në atë se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, nga neni 261 (10 pika 5 dhe 2) të KPK. Kjo e bënë të pa qartë tërësisht këtë pjesë të dispozitivit të aktgjykimit. Për këto arsye gjykata e shkallës së dytë, aktgjykimin e shkallës së parë, duhet ta prish dhe lënda të kthehet në rivendosje për shkak të shkeljeve esenciale të natyrës relative të dispozitave procedurale. Dispozitivi nën II, pika a, është i pa qartë për faktin se fare nuk bëhet përshkrimi i veprimeve inkriminuese të akuzuarit O.I. Nga ky dispozitiv bënë të kuptohet se i pandehuri O.I., nuk është fare kryes i kësaj vepre penale. Si karakteristikë e veprimeve të inkriminuara të kësaj vepre është se këtë mund ta kryej me dashje vetëm personi përgjegjës në organizatën e biznesit, i cili me veprimet e veta duhet të sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm organizatës së biznesit ku punon apo organizatës tjetër të biznesit. Gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike në drejtim të asaj se i pandehuri Orhan, i sjellë dobi pasurore organizatës tjetër të biznesit, respektivisht kredi marrësve. Gjykata e shkallës së parë, nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike kur ka konstatuar se i pandehuri Orhan, si drejtor ekzekutiv i xxx3, i ka kryer dy veprat penale, të theksuara më parë. Edhe në rast se eventualisht ka gjetur një lloj përgjegjësie tek i akuzuari, ajo në asnjë mënyrë në veprimet e tija, si në rastin konkret nuk ka mundur të sajojë dy vepra penale të ndryshme për të njëjtat veprime. Kur veprat penale janë të lidhura dhe të kushtëzuara funksionarisht në mes veti, vepër me përgjegjësi më të madhe zakonisht e konsumon veprën sekundare. I pandehuri në asnjë mënyrë nuk ka mundur të kryej edhe veprën penale lidhja e kontratave të dëmshme, në raste se më parë, ka kryer veprën penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi. Në rast se dashja e personit me autorizime të veçanta është për të kryer veprën penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, me lejimin e kredisë së dëmshme, atëherë lidhja e kontratave në këtë rast është produkt i veprës së parë penale, respektivisht finalizim i veprës penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi.

-Mbrojtësi i të akuzuarit B.H1., av.Ramë Gashi, si dhe vetë i akuzuari, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së kodit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, të aprovoj ankesën e mbrojtësve dhe të akuzuarin B.H1., në mungesë të provave ta liroj nga akuza apo çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe vendosje.

Pretendimet lidhur me shkeljet esenciale nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPK, përmbahen në atë se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i pa kuptueshëm, kundërthënës me brendinë e tij dhe të dhënat në arsyetimin e aktgjykimit. Në dispozitivin II.a, i akuzuari B.H1., është shpallur fajtor për veprën penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi në bashkëkryerje nga neni

261 (10 pika 5 dhe 2) të KPK. Neni 261 i KPK, përcakton veprën penale të mashtrimit, e jo veprën penale të keqpërdorimit të autorizimit në ekonomi, siç ceket në dispozitiv të aktgjykimit. Ky fakt në mënyrë të qartë e bënë dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar, të pa kuptueshëm, kundërthënës me përmbajtjen e aktgjykimit dhe në kundërshtim me gjendjen faktike, të cilën e arsyeton vetë gjykata e shkallës së parë. Kjo është e mjaftueshme për tu konsideruar shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale, nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPK. Mbrojtja si fakt tjetër, të shkeljes esenciale, pretendon se gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e kundërshtuar nuk paraqet asnjë arsyetim lidhur me nenin 23 të KPK, përkatësisht faktin se vepra është kryer në bashkëveprim me të pandehurit e tjerë. Gjykata e shkallës së parë, ka dështuar të argumentoj dhe arsyetoj kinse bashkëkryerjen e veprës penale nga ana e B.H1.t, me të pandehurit e tjerë. Nuk ka asnjë provë në bazë të së cilës mund të del ndonjë formë e bashkëpunimit, midis B.H1.t dhe të pandehurve të tjerë, dhe kujdo nga menaxhmenti i bankës, apo stafi administrativ i bankës, për kohën derisa B.H1., ishte anëtar i këshillit drejtues të bankës. Kjo në asnjë mënyrë nuk del as nga shkresat e lëndës e të cilat janë administruar si prova e aq më pakë nga ekspertiza financiare e cila qartë ka definuar se përgjegjësia për kreditë është individuale dhe i takon kredi marrësit. Kështu është deklaruar eksperti financiar edhe në shqyrtimin gjyqësor me gojë. Të gjithë punëtorët e bankës, kanë deklaruar se B.H1., asnjëherë nuk ka pasur ndikim e as nuk i ka kontaktuar si anëtar të këshillit drejtues të bankës, për ndonjë kredi të kujt do qoftë. B.H1., duke qenë anëtar i Bordit të akcionarëve në xxx3, asnjëherë për vete nuk kishte marrë asnjë kredi nga ajo bankë. Ai në bankë ndodhej vetëm kur merrte pjesë në mbledhje të bordit. Kur nuk kishte pasur asnjë implikim as më të voglin, lidhur me kreditë që i kanë marrë vëllezërit e tij. Dëshmitari E.D., i cili po ashtu ka punuar në bankë, deklaroi se B.H1., si anëtar i bordit, nuk ka pasur kurrfarë interesimi për subjekte të caktuara, për ndarje të kredive. Pra, përgjegjësitë për kreditë e marra iu takojnë atyre që i kanë marrë dhe atyre që i shfrytëzojnë (ankesë e përbashkët e mbrojtësit dhe e vet të akuzuarit).

Mbrojtësi i të akuzuarit H.G., av. Destan Rukiqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së kodit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, të aprovoj ankesën e mbrojtësve dhe të akuzuarin H.G., në mungesë të provave ta liroj nga akuza apo çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe ri vendosje.

Shkeljet esenciale sipas mbrojtjes janë nga neni 403 par.1 nën par.8 dhe 12 dhe par.12 të KPPK, që e bëjnë aktgjykimin të kundërligjshëm dhe të pa qëndrueshëm, duke pretenduar se aktgjykimi është bazuar në prova të pa pranueshme, ngase dëshmitarët D.P., E.D. dhe V.M., në fillim janë marrë në pyetje në cilësinë e të dyshuarve, ndërsa pa prezencën e mbrojtësve. Andaj, pretendon se këto prova janë të pa pranueshme në pajtim me nenin 153 të KPPK, e të cilat gjykata e shkallës së parë, do të duhej ti veçonte nga shkresat e lëndës, mbështetur në nenin 154 par.4 të KPPK. Duke vepruar kështu gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale edhe nga neni 403 par.1 nën par.8 të KPPK. Gjithashtu, ceket se procedura penale është zgjatur pa arsye e që në rastin konkret është shkelur konventa evropiane për të drejtat e njeriut, neni 6 i konventës, ku aktakuza në gjykatë është dorëzuar me

dt.26.02.2007, shqyrtimi gjyqësor ka filluar me dt.02.03.2010, ka përfunduar me dt.11.05.2011, ndërsa aktgjykimi i është dorëzuar palëve me dt.12.11.2012, pra pesë vite, nga momenti i dorëzimit të aktakuzës në gjykatë deri në dorëzimin e aktgjykimit të palëve. Gjithashtu, edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar ngase asnjë dëshmi e drejtpërdrejt apo e tërthortë nuk vërteton faktin se i akuzuari H.G., ka ndikuar tek organet e bankës, që ndonjëri nga huamarrësit të merr kredi. Këtë e dëshmojnë dëshmitarët D.P., N.S., të punësuar në xxx3, si dhe dëshmia e ekspertit financiar X.K., mirëpo, gjykata këto i ka vlerësuar në mënyrë të një anshme.

-Ankesë ka ushtruar edhe i akuzuari B.H1., i cili edhe pse nuk i cekë bazat ankimore, nga përmbajtja voluminoze e ankesës shihet se të njejtën e kundërshton për të gjitha bazat ankimore, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, të aprovoj ankesën e tij dhe në mungesë të provave ta liroj nga akuza apo çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe ri vendosje. Ka shtuar ndër të tjera se nga procesverbalet origjinale e jo ato të falsifikuar të mbledhjeve të Bordit mund të shihet se i Bordi nuk ka lejuar kredi, se ka kërkuar nga Gjykata e shkallës së parë të kërkojë nga Banka procesverbalet origjinale dhe fletoren që gjendet në arkiv por se, gjykata nuk ka aprovuar këtë kërkesë.

-Ankesë ka paraqitur edhe xxx3, e cila edhe pse nuk e ka cekur bazën ankimore nga përmbajtja shihet se përshkruan gjendjen aktuale të obligimeve për secilin të akuzuar dhe se vlerëson se dënimet nuk janë peshuar drejtë në raport me dëmet e shkaktuar ndaj kursimtarëve. ka propozuar që gjykata të i kushtëzon dënimet me kryerjen e obligimeve ndaj bankës.

Gjykata e Apelit e Kosovës e caktoj dhe e mbajti seancën kolegjit konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP, për të cilën i njoftoj palët. Në seancë prezantoi Prokurori i Apelit Haxhi Dërguti, të akuzuarit H.S., M.K., Z.S., O.I., B.H1. dhe H.G.. mbrojtësit e të akuzuarve avokatët Osman Havolli, Ahmet Hasolli, Qerim Metaj, Avdi Ahmeti, Nikë Shala, Abdylaziz Sadiku, Ramë Gashi dhe Destan Rukiqi si dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar Ragip Krasniqi. Prokurori i Apelit e mbështeti propozimin e bërë me shkrim PPA/I.nr.79/13 datë 05.06.2013, me të cilin ka propozuar që të refuzohet si e pabazë ankesa e mbrojtësve të akuzuarve. Mbrojtësit e të akuzuarve mbështetën pretendimet e tyre në ankesa për çka të akuzuarit i mbështetën mbrojtësit e tyre. Pala e dëmtuar deklaroi se qëndron pranë dy parashtrësive që në ndërkohë i ka dorëzuar gjykatës së shkallës së dytë e që ka të bëjë me dinamikën e pagesës së borxheve nga të akuzuarit dhe forcimit të kolateralit.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e kësaj lënde, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi:

- aktgjykimi duhet anuluar dhe të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e atakuar si dhe pretendimet e mbrojtësve dhe vlerëson se:

1. Aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që nuk përmban elementet dhe formën që kërkohet në bazë të nenit 370 të KPP. Sipas par.2 të këtij neni „ *hyrja e aktgjykimit përfshin: shënimin se aktgjykimi merret në emër të popullit, emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit dhe të anëtarëve të trupit gjykues dhe të procesmbajtësit, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit, veprën penale për të cilën i akuzuari është dënuar dhe nëse ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ditën e shqyrtimit gjyqësor, nëse shqyrtimi gjyqësor ka qenë i hapur, emrin dhe mbiemrin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe të përfaqësuesit të autorizuar të cilët kanë qenë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor, datën e shpalljes së aktgjykimit të shqiptuar dhe datën e përpilimit të aktgjykimit*”

1.1 Aktgjykimit të atakuar i mungojnë shumica e këtyre elementeve siç është: *emri dhe mbiemri i procesmbajtësit, emrat dhe mbiemrat e të akuzuarve, veprat penale për të cilat ata akuzohen dhe janë dënuar dhe nëse kanë qenë të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, nëse shqyrtimi gjyqësor ka qenë i hapur, emrin dhe mbiemrin e prokurorit të shtetit, mbrojtësve të akuzuarve, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, data e shpalljes së aktgjykimit të shqiptuar dhe data e përpilimit të aktgjykimit*”

Gjykata e Apelit vlerëson se kur shkeljet e procedurave penale do të ndaleshin me vetëm këto gabime, nuk do të kishte arsye të dërgohej lënda për rigjykim sepse të gjitha elementet relevante janë të pranishme në shkresat e lendes. Kështu që këto shkelje mund të zgjedhën me se miri duke modifikuar aktgjykimin e Shqyrtimit Kryesor. Këto shkelje në vete nuk do të ngitnin pyetjen e ligjshmërisë e aktgjykimit të Trupit Gjykues. Mirëpo, kur merren parasysh një numër i madh i shkeljeve tjera që janë të treguara me poshtë atëherë Gjykata e Apelit konkludon se këto shkelje kontribuojnë në rezultatin e përgjithshëm që është i kundërligjshëm.

1.2. Dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm dhe i paqartë nuk përkon me arsyetimin dhe faktet vendimtare të paraqitura nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Nuk është e qartë se cilat fakte janë shpallur të vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk ekziston përshkrimi faktik i cili do të sqaronte se cilat janë veprimet konkrete inkriminuese të akuzuarve dhe se me cilat prova janë vërtetuar këto veprime. Gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të pikës I/a, përshkruan ndër të tjera „ ... *ka mashtruar palën e dëmtuar xxx3 duke fshehur fakte lidhur me gjendjen financiare për të kthyer borxhin.....*” duke mos specifikuar se me cilat fakte të fshehura kanë kryer këtë mashtrim të akuzuarit dhe për cilat organizata afariste të tyre kanë kryer mashtrimet. Po ashtu njëjtë është edhe sa i përket pikës II/a ku dispozitivi është krejtësisht i pa qartë, duke mos përshkruar veprimet individuale të secilit të akuzuar dhe provat që e mbështesin një pretendim të tillë. Edhe në këtë rast nuk ceken organizatat e tyre përfituese me anë të keqpërdorimit të autorizimeve në ekonomi.

1.3 Duke analizuar aktakuzën dhe aktgjykimin e atakuar, shihet se gjykata shumicën e dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria nuk i ka dëgjuar fare, siç janë: M.S., E.N., E.H., B.T., A.L., B.C., F.N., L.B., F.K., M.R., H.H., R.S., R.G., D.C., T.C. si dhe deklaratat e dëshmitarëve-huamarrësve të cilët deklaratat e tyre i kanë dhënë vetëm në polici e të cilat gjykata në faqen e 12 (versioni në gjuhën shqipe) i ka administruar si prova, e ku deklaratat e tilla iu janë pamundësuar të akuzuarve dhe mbrojtësve që ti kundërshtojnë. Nga procesverbali i shqyrtimit kryesor por edhe nga aktgjykimi nuk mund të konstatohet se a ka hequr dorë prokurori nga dëgjimi i këtyre dëshmitarëve apo për ndonjë arsye tjetër nuk janë dëgjuar e që nuk ceket në aktgjykim. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë në rast se nuk ka hequr dorë nga ana e prokurorit lidhur me dëgjimin e këtyre dëshmitarëve, të njëjtit nëse mund të sigurohen të ftohen dhe pas marrjes së deklaratave të njëjtat të vlerësohen dhe të arsyetohen për faktet eventuale të vërtetuara apo të pa vërtetuara.

1.4 Gjykata e Apelit, pajtohet me pretendimet e mbrojtësve të akuzuarit H.S., se sa i përket të akuzuarve H.S., M.K. dhe B.H1, gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.10 të KPP, pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me tejkalim të akuzës në dëm të akuzuarve H.S., M.K.dhe B.H1., të cilët sipas aktakuzës së ndryshuar akuzohen për ndihmë në Mashtrim nga neni 261 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 dhe 25 të KPK, ndërsa në aktgjykim janë shpallur për shkak të veprës penale Mashtrim nga neni 261 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

1.5. Gjykata e shkallës së parë siç shihet edhe nga aktgjykimi ka administruar 150 prova materiale, të cilat vetëm i ka cekur sipas renditjes, por të njëjtat fare nuk i ka elaboruar, shqyrtuar dhe vërtetuar duke dhënë arsyet se të njëjtat çfarë relevance dhe lidhje kauzale kanë me tërë çështjen penale në përgjithësi dhe me të akuzuarit në veçanti. Psh. prova nr. 1 që ceket „ Deklarata e garancisë nr.26/05’’, e njëjta fare nuk arsyetohet e as që vlerësohet se çka përmban, se çka e inkriminon ndonjërin apo të gjithë të akuzuarit dhe me cilat prova e njëjta është në përputhje e që të njëjtën do ta bënte provë relevante me të cilën vërtetohet ose jo fajësia e të akuzuarve.

1.5 Gjykata po ashtu me administrimin e provave personale siç është marrja në pyetje e më shumë se 30 dëshmitarëve, vetëm ka përshkruar deklaratën e tyre dhe me secilën prej tyre është mjaftuar me konstatimin se psh. në deklaratën e dëshmitares D.P. „, se deklarata e saj duhet të konsiderohet e besueshme. Ka marrë pjesë në takime të bordit menaxhues dhe ajo i ka njoftuar anëtarët lidhur me situatën aktuale sa i përket kredive, Ka pranuar se përgjegjësia për kreditë e mëdha është pranuar nga aksionarët të cilët ishin pjesë e bordit, që vërtetohet me dokumente objektive-procesverbalet e marra gjatë seancës së këshillit menaxhues’’. Nga një konkludim i tillë i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të konkludohet se çka në fakt gjykata ka vërtetuar me këtë dëshmi, veprimet inkriminuese të cilit të akuzuar apo ndoshta të të gjithëve janë vërtetuar nga kjo deklaratë, se kjo deklaratë me cilat prova të tjera të administruara është në përputhje të plotë e që do të vërtetonin fajësinë e të akuzuarve dhe se çka mendohet me këshillin menaxhues. Prandaj gjykata e shkallës së parë në rigjykim nuk ka nevojë që të thërras edhe një herë dëshmitarë

e dëgjuar në shqyrtim kryesor (përveç nëse duhet vërtetuar ndonjë fakt tjetër) por duhet që të gjitha këto deklarata ti shqyrtoi secilën veç e veç, e pastaj të konstatojë kredibilitetin e këtyre deklaratave, lidhjen kauzale të këtyre dëshmime me veprimet e të akuzuarve, faktet që provohen nga këto dëshmi dhe pastaj të njëjtat ti harmonizojë me provat e tjera dhe varësisht nga rezultati i tyre të merr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

1.6 Aktgjykimit i mungojnë në tërësi pretendimet e mbrojtjes dhe të akuzuarve të dhëna në shqyrtim kryesor si dhe në fjalën përfundimtare, e po ashtu gjykata nuk është përgjigjur në asnjë pretendim të mbrojtjes apo të akuzuarve, se përse ia falë apo nuk ia falë besimin provave mbrojtëse. Po ashtu qëndrojnë pretendimet e avokatit Osman Havolli që gjykata nuk është përgjigjur në disa pretendime të tyre të dorëzuara me shkrim dhe të potencuara në procesverbalin e shqyrtimit kryesor. Nga shkresat e lëndës shihet se mbrojtësit i janë drejtuar disa herë me shkresa gjykatës, për shqyrtimin e fakteve të reja dhe kundërshtimi i mbrojtësve mbi përmbajtjen e provave (parashtresat e datës 31.12.2010, 06.05.2010, 26.05.2010), por këto shqetësime të tyre nuk u morën në shqyrtim fare. Edhe kërkesës së akuzuarit B.H1., që të sigurohen procesverbalet e mbledhjeve të bordit si dhe fletorja me shënime që gjendet në arkivin e bankës, gjykata nuk ka vendosur lidhur me këtë kërkesë duke e injoruar të njëjtën.

2. Sa i përket ekspertizës së ekspertit financiar X.K., kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë të njëjtën e ka vlerësuar në mënyrë selektive duke aprovuar të njëjtën pjesërisht, edhe pse të njëjtin e kishte angazhuar vetë gjykata e po ashtu kishte urdhëruar edhe plotësimin e ekspertizës. Gjykata e shkallës së parë me këtë rast konstaton se mendimi i dytë i ekspertit është plotësisht i pa besueshëm dhe ën kundërshtim me mendimin e detajuar dhe të besueshëm të dhënë më herët, por të njëjtën nuk e arsyeton se përse nuk ia falë besimin dhe të njëjtën e vlerëson vetëm në ato pjesë që janë në disfavor të akuzuarv dhe vepron në kundërshtim me nenin 136 dhe 142 të KPP ku thuhet „ *në qoftë se të dhënat në konstatimin e ekspertëve ndryshojnë thelbësisht ose kur konstatimet e tyre janë të pa qarta, jo të plota apo në kontradiktë me vetveten ose me rrethanat e shqyrtuara e në rast se këto të meta nuk mund të mënjahohen me marrjen e serishme në pyetje të ekspertëve, mund të kërkohet mendimi i ekspertëve të tjerë*”, ashtu që në këtë rast, gjykata është dashur të angazhojë edhe një ekspert dhe nëse eventualisht në mes të ekspertizës së parë dhe ekspertizës së dytë të dhënë nga eksperti tjetër përsëri ka kundërthënë, atëherë gjykata duhet të urdhërojë super ekspertizë, ku do të merrnin pjesë së paku tre ekspert financiar, pasi që në kësaj situata super ekspertiza përbëhet nga dy apo më shumë ekspert, gjegjësisht fakultetit përkatës apo ndonjë institucioni shkencor apo profesional, duke u nisur nga paragjykimi se kështu do të fitojmë një mendim më autoritativ se sa mendimi i individit.

Çështja që mbeti kontestuese nga ekspertiza financiare e që gjykata nuk ia fali besimin ndërsa dështoi të deklarohet dhe të jap mendimin e saj si dhe të individualizoj përgjegjësitë është:

- a) Se a ishte Banka Kreditore e Prishtinës, në situatë të tillë financiare sa të falimentohej, ku sipas kësaj gjykatë eksperti ishte i qartë dhe konkret.

- b) A ka qenë një ndër shkaktarët e përkeqësimit të situatës financiare të bankës, prishja e kontratës për depozita nga ana e PTK-së.
- c) Çështja e afateve në kthimin e kredive.
- d) Mos aprovimi nga BPK-ja e vendimit mbi riprogramimin e disa kredive të miratuara nga bordi menaxhues me 29.12.2005.
- e) Mendimi i ekspertit lidhur me memorandumimin e mirëkuptimit të propozuar nga BPK-janë 28.09.2005 ku kemi dy konstatime të ekspertit financiar.
- f) A ishin solvente kompanitë huamarrëse dhe a ishin të mbuluara me kolateral sipas rregullave të përcaktuara nga banka dhe BQK.
- g) Dhe në fund nuk ka vlerësuar mendimin e ekspertit se përgjegjësi për marrjen e kredive secili huamarrës ka kontraktuar në emër të vet dhe për interes të bizneseve të tyre dhe se secila kompani kredit marrëse për obligimet e veta kontraktuale është përgjegjëse për shumat e kredisë.....

Prandaj është e domosdoshme që në ekspertizë të re të ri sqarohen këto çështje dhe sidomos çështja e përgjegjësisë së secilit huamarrës lidhur me këto kredi dhe varësisht nga konstatimi i ri i ekspertit apo ekspertëve të merret pastaj vendim i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo është më se e rëndësishme sepse nga një përfundim i tillë varet edhe ekzistenca apo mosekzistenca e grupeve të cilat prokuroria dhe gjykata i emërton sipas mbiemrave të akuzuarve (grupi H., S., H1, H2, N).

Gjykata e shkallës së parë në faqen 49 paragrafi 2, thekson „*se synimi për të përfutuar materialisht në mënyrë të paligjshme duhet të ekzistojë në kohën kur akti i mashtrimit është duke u kryer. Pra nuk ka mashtrim, nëse një blerës i mallit me kredi vetëm më pas vendos të mos e kthejë kredinë dhe kështu të përfutojë materialisht në mënyrë të paligjshme*”. Mirëpo arsyetimin e dhënë më tutje nuk e bazon në prova të caktuara duke mos specifikuar se me cilat veprime apo prova konstatohet se të akuzuarit në momentin e aplikimit apo thjesht me rastin e aplikimit për kredi të huamarrësve që janë në cilësi të dëshmitarëve kishin për qëllim mashtrimin dhe se nuk kanë pasur qëllim kthimin e kredisë që nga fillimi i marrjes së kredive. Gjykata me këtë rast nuk ka dhënë po ashtu përgjigje edhe në pretendimet e mbrojtjes e që ceken edhe në ankesa kundër këtij aktgjykimi se a kemi në rastin konkret raport juridiko-civil apo me vepër penale të mashtrimit, për çka në cilën do rrethanë gjykata është dashur që të jep vlerësimin e saj.

3. Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se në lidhje me të akuzuarin O.I., është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, pasi që i akuzuari O.I. për të njëjtat veprime inkriminuese që konsiderohen të vërtetuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e ka shpallur fajtor të akuzuarin për dy vepra penale dhe atë për, Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, nga neni 236 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe për veprën penale Lidhja e Kontratës së dëmshme nga neni 237 par.1 dhe 2 të KPK-së. Kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret mbizotëron teoria e konsumcionit, pasi që i akuzuari lidhjen e kontratës së dëmshme e ka arritur përmes keqpërdorimit të autorizimit në ekonomi, kështu që vepra penale e Lidhjes së kontratës së dëmshme nga neni 237 par.1 dhe 2 të KPK-së, si vepër më e rëndë penale e konsumon veprën penale të Keqpërdorimit të autorizimit në ekonomi nga neni 236 par.1 dhe 2 të KPK-së, si vepër më e

lehtë. Prandaj gjykata e shkallës së parë në rigjykim ndaj të akuzuarit O.I. të procedojë vetëm për veprën penale Lidhja e kontratës së dëmshme nga neni 237 par.2 të KPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka lirinë e veprimit rreth vlerësimit të provave ndërsa Gjykata e Apelit vetëm bën rivlerësimin e provave nëse gjenë gabime në vlerësimin e gjykatës dhe se vetëm në raste të jashtëzakonshme bën administrimin e provave me hapjen e shqyrtimin në shkallë të dytë. Kjo gjykatë ka gjetur se përshkrimi faktik nuk është bërë sa duhet në aktgjykim dhe se arsyetimi është i pamjaftueshëm. Pasi që aktgjykimi është në kundërshtim me dispozitat e KPP-së, se është e pa qartë se çfarë janë gjetjet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe mënyra se si kjo gjykatë ka ardhur deri te përfundimet e këtilla, Gjykata e Apelit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në rastin në fjalë të pandehurit H.S., B.H1.dhe M.K. janë akuzuar për kryerjen e një veprë penale të mashtrimit sipas nenit 261 (1) dhe (2) KPK, dënohet me burgim një deri në pesë vjet. Gjykata e Apelit vëren se në bazë të nenit 90 (1) 4) KPK ndjekja penale mund të mos fillojë pas pesë vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim prej më shumë se 3 vjet, por jo më shumë se 5 vjet. Sipas Nenit 91 (1) afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon në ditën kur është kryer vepra penale. Edhe pse sipas par (3) të njëjtit nen afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer, megjithatë, në bazë të par. (6) të të njëjtit nen ndjekje penale do të ndalohet në çdo rast kur afati i parashkrimit ka kaluar dy herë. Këta të pandehur janë, ndër të tjera, të akuzuar për veprën penale të Mashtrimit në pajtim me nenin 261 (1) dhe (2) në lidhje me nenin 23 KPK në lidhje me:

- 300 000 Euro kredi për kompaninë xxx në Shkurt 2004 (H.S.);
- 231 950 dhe 218 050 Euro kredi për kompaninë xxx1. në Mars 2004 (B.H1); dhe
- 300 000 Euro kredi për kompaninë xxx2 në shkurt 2004 (M.K.).

Pasi që për veprat e mësipërme që H.S., B.H1.dhe M.K. janë të akuzuar, janë kryer më shumë se 10 vjet më parë, ka një pengesë absolute mbi ndjekjen penale për shkak të kalimit të afatit të përcaktuar në nenin 91 (6) të KPK-së . Prandaj, në bazë të nenit 389 1) i KPPK dhe neni 426 (1) KPPK, akuzat ndaj të pandehurve H.S., B.H1.dhe M.K. duhet të refuzohen.

Nga arsyet e sipër cekura aktgjykimi i ankimuar juridikisht është i paqëndrueshëm dhe si i tillë është dashtë të anulohet dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Në rigjykim Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e lartcekura, t'i eliminoj të gjitha shkeljet e cekura, t'i administroj të gjitha provat dhe të njëjtat t'i vlerësoj në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.6 dhe 7 të KPP, dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerr konkluzione të drejta të ligjshme e të bazuara në provat e administruara e mandej të merr vendim përkatës.

Gjykata e Apelit e Kosovës, hudhi si të pa lejuar ankesë e palës së dëmtuar, kjo për faktin se sipas dispozitës së nenit 381 par. 3 të KPP, i dëmtuari mund të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionin penal për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale, e që në rastin konkret vepra penale për të cilën janë shpallur fajtor të akuzuarit nuk hyn në veprat penale që lejohet ankesa e të dëmtuarit.

Nga çka u tha më lart, e në pajtim me dispozitën e nenit 402 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.135/2013, më 06.02.2014

Procesmbajtësja,
Andres Parmas

Kryetarja e kolegjit – gjyqtarja,
1. Annemarie Meister

Anëtarët e kolegjit:

2. Abdullah Ahmeti _____

3. Driton Muharremi _____